

Nr. 2717/1 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 24.06.2022

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Znj

Sekretar i Përgjithshëm

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

(Rr. "Abdi Toptani" Nr. 1, 1001, Tiranë)

E nderuar **Znj.**

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 3947/1 Prot. dt. 06.06.2022, me objekt "Dërgohet për trajtim kërkesa për informacion e Znj. [] hyrë në KESH sh.a me Nr. 27717 Prot, datë 07.06.2022, Ju informojmë si më poshtë:

Pyetja 1: Cilin version ka zgjedhur ministria, në kuotën $m=443$ apo $m=488$ mbi nivelin e detit?

Përgjigje: Aktualisht janë duke u shqyrtuar dy vendndodhje të mundshme të Digës dhe konkluzionet lidhur me vendndodhjen e preferuar pritet të përfundohen në tremujorin e tretë të vitit 2022. Bazuar në përfundimet alternativës së vendndodhjes do të nisë edhe puna për projektin paraprak, ku do të përfshihen edhe vlerësime të kostove dhe planit të zbatimit.

Vrojtimet në terren dhe angazhimet që janë duke u kryer e do të kryhen kanë objektivin e grumbullimit të informacionit që do të merret në konsideratë si pjesë e procesit të përcaktimit të alternativës më të mirë për Projektin.

Pyetja 2: Në cilin stad ndodhet studimi i fizibilitetit dhe nëse është i përfunduar, mund të kem një kopje?

Përgjigje: Në zbatim të parashikimeve të ligjit Nr. 38/2021 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel International, Inc.", për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës" (në vijim "Ligji 38/2021") dhe VKM nr.485, datë 30.7.2021 "Për miratimin e kontratës së fazës së parë "kontratë për shërbime teknike - projekti Hidroenergjetik i Skavicës" ndërmjet KESH SHA dhe Bechtel Limited", shoqëria Bechtel Limited (në vijim "Bechtel") është duke zhvilluar fazën e parë të projektit për ndërtimin e HEC Skavica. Referuar parashikimit të pikës 2 të nenit 2 të ligjit 38/2021 shoqëria Bechtel është në proces realizimi të veprimtarive të mëposhtme:

- matje topografike dhe studime hidrologjike në mbështetje të zhvillimit të projektimit;
- studime dhe inspektime gjeoteknike në terren;
- zhvillimin e strategjisë për realizimin e projektit;

- d) rishikimin dhe finalizimin e vlerësimit të ndikimit mjedisor e social;
- e) përgatitjen e projektit teknik, përfshirë përzgjedhjen e furnitorit të turbinave, me qëllim preventivin e kostove dhe të sasive; dhe shërbime të tjera të dakordësuara për të mundësuar ecurinë e zhvillimit të projektimit të hidrocentralit të Skavicës. Alternativat për vendndodhjen e digës dhe elementeve të tjera të Projektit;
- f) llojin dhe lartësinë e digës;
- g) korridorin e linjës së transmetimit;
- h) rrugët hyrëse dhe facilitetet e përkohshme;
- i) vlerësimet gjeologjike, gjeoteknike, hidrologjike, të ndryshimit të klimës dhe përmbytjeve;
- j) studimet për fuqinë dhe prodhimin e energjisë;
- k) tunelet për skemën hidrike.

Aktualisht kontraktori po vijon me mbledhjen dhe vlerësimin e të gjitha informacioneve të nevojshme për realizimin e procesit të përzgjedhjes së alternativës më fizibël.

Në punën e saj për realizimin e fazës së parë të projektit, Bechtel mbështetet nga kompani ndërkombëtare si Mott MacDonald (për pjesën inxhinierike) dhe Golder (për ndikimin mjedisor dhe social (VNMS)).

Pyetja 3: Sa është numri i banorëve që preken drejtpërdrejt dhe sa e banorëve që preken jo drejtpërdrejt nga projekti HEC Skavica? Cilët janë zonat apo njësitë administrative që preken drejtpërdrejt dhe jo drejtpërdrejt?

Përgjigje: Projekti i propozuar i hidrocentralit të Skavicës parashikohet të jetë në zonën verilindore të Shqipërisë, rreth 75 km nga kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana. Lumi Drini i Zi vjen në Shqipëri nga Maqedonia e Veriut dhe rrjedh nga liqenet e Prespës dhe Ohrit. Veprat e projektit janë parashikuar të pozicionohen në rrjedhën e sipërme (biefin e sipërm) të lumit Drini i Zi, përpara vend bashkimit të tij me Drinin e Bardhë dhe fundit të rezervuarit të Hidrocentralit të Fierzës në lumin Drin.

Vendndodhja e saktë e digës dhe kufijtë e rezervuarit nuk janë përcaktuar ende dhe aktualisht janë duke u studiuar dy vendndodhje alternative. Për këtë arsye edhe lista përfundimtare e bashkive, njësite administrative dhe fshatrave që mund të preken nga Projekti nuk është përfunduar ende. Në çdo rast, Projekti pritet të prekë më shumë bashkinë Dibër dhe pjesërisht bashkinë Kukës. Fshatrat që ndodhen më pranë lumit Drin janë ato që kanë më shumë të ngjarë të preken nga rezervuari.

Gjurma e saktë e linjave të transmetimit po ashtu nuk është përcaktuar ende. OST aktualisht ka përcaktuar një korridor. Korridori i linjës së transmetimit që po shqyrtohet kalon nga Skavica në Shumat, kryesisht brenda qarqeve të Kukësit dhe Dibrës.

Përcaktimi i vendndodhjes së saktë të digës dhe kufijtë e rezervuarit do të përcaktohen nëpërmjet një studimi fizibiliteti i cili do të marrë në konsideratë faktorët mjedisorë, socialë, teknikë dhe ekonomikë.

Pyetja 4: Cila është praktika e konsultimit paraprak me banoret në fazat e fillimit të projektit dhe aktualisht? Në detyrimin për konsultimin publik, cilët nga aktoret që preken janë konsultuar, për shembull a janë ato banorë që preken drejtpërdrejt, banorë që preken jo drejtpërdrejt, nëse janë aktore të shoqërisë civile, përfaqësues lokale të njësive administrative etj.? Cilët janë rezultatet e konsultimit publik dhe është e mundur të marr praktikën e këtij konsultimi nëse është i përfunduar?

Përgjigje: Një studim i veçantë, i quajtur raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) është duke u përgatitur me qëllim identifikimin, reduktimin dhe/ose menaxhimin e duhur të ndikimeve që do të krijojë projekti. Raporti i VNMS është një kërkesë e legjislacionit shqiptar dhe është duke u përgatitur gjithashtu në përputhje me Standardet e Performancës së IFC të cilat përcaktojnë kërkesa strikte në lidhje me mënyrën se si duhet të menaxhohen risqet dhe ndikimet e Projektit.

Raporti i VNMS është duke u realizuar nga Golder, një kompani me eksperiencë dhe e njohur ndërkombëtarisht.

Studimi i VNMS do të vlerësojë me kujdes:

- ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të Projektit (si ato negative ashtu edhe ato pozitive);
- mënyrat se si ndikimet negative mund të shmangen, minimizohen dhe/ose korrigjohen qysh në fazat e hershme të hartimit të projektit;
- ndikimet e mundshme në jetesën e komuniteteve të prekura, grupet në nevojë, infrastrukturën sociale, trashëgiminë kulturore si dhe burimet natyrore;
- qasjen dhe parimet e kompensimit dhe zhvendosjes nëpërmjet hartimit të dokumentit të Politikave Kuadër të Zhvendosjes i cili do të orientojë Planin e Veprimit të Zhvendosjes;

Janë kryer tashmë studimet e gjendjes ekzistuese mjedisore për sezonet e verës, vjeshtës dhe dimrit. Pjesa e mbetur e studimeve mjedisore si dhe studimet e gjendjes ekzistuese sociale do të kryhen brenda vitit 2022.

Diskutimet fillestare me palët e interesit si dhe studimet që do të pasojnë do të përfshihen në draft raportin e VNMS. Raporti po ashtu do të përfshijë strategjinë e propozuar për kompensimin dhe zhvendosjen dhe më pas do të ndahet me komunitetet e prekura për të marrë opinionet dhe komentet e tyre. Raporti pritet të jetë gati për opinionet dhe komentet e publikut gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022. Gjatë fazës së hartimit të raportit janë realizuar angazhime të ndryshme në nivel lokal dhe qendror me qëllim grumbullimin e informacioneve të nevojshme. Më tej, me hartimin e draft raportit, marrja e opinioneve nga palët e interesit dhe publiku i gjerë do të realizohet nëpërmjet dëgjësave të hapura publike ku do të prezantohen ndikimet sociale dhe mjedisore të evidentuara si dhe masat e propozuara për eliminimin, minimizimin dhe trajtimin e tyre. Bazuar në legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, opinionet e marra nga palët e interesit në këto dëgjesa publike do të reflektohen më pas në raportin përfundimtar. Konsultimet me publikun do të realizohen sipas parashikimeve ligjore dhe standardeve ndërkombëtare të cilat do të kryhen me përfundimin e studimeve, raporteve dhe konkluzioneve për projektin e propozuar.

Pyetje 5: Mundet të marr raportin nga kompania të gjetjeve të studimit hidrologjik, sedimentar, sizmologjik dhe të tjera të kryera në fazën e parë të projektit nga Bechtel?

Përgjigje: Sjellim në vëmendjen tuaj se për sa i përket raporteve të cituara nga ana juaj (raportet e studimeve hidrologjike, sedimentare, sizmologjike, gjeologjike dhe gjeoteknike së bashku me studimet e raportet e nevojshme për ndikimet sociale dhe mjedisore) kontraktori është në fazën e hartimit të dokumentacionit dhe kryerjes së studimeve të nevojshme në terren dhe për rrjedhojë nuk disponojmë ende një raport përfundimtar për ta vënë në dispozicion të palëve të interesit.

Nga ana e shoqërisë KESH sh.a është vlerësuar se materialet studimore për qëllime përdorimi edhe në të ardhmen do të dërgohen pranë bibliotekës kombëtare, ku mund të aksesohen nga çdo i interesuar.

Pyetje 6: Jam e interesuar të lexoj studimin e para-fizibilitetit të kryer për këtë projekt. Mundet të kem një kopje të këtij raporti?

Përgjigje: Fizibiliteti i projektit do të shqyrtohet duke marrë në konsiderate tërësinë e studimeve që janë duke u realizuar dhe që janë përmendur edhe më lart përfshi ato teknike, inxhinierike, sociale, mjedisore si dhe ekonomike e financiare. Ky është edhe një nga objektivat e kësaj faze të parë të projektit, ashtu siç edhe përcaktohet në VKM 485, datë 30.7.2021 "Për miratimin e kontratës së fazës së parë "kontratë për shërbime teknike - projekti Hidroenergjetik i Skavicës" ndërmjet KESH sh.a dhe Bechtel Limited"

Pyetje 7: Jam e interesuar të di cili është grupi negociator për fazën e parë dhe për fazën e dytë të këtij projekti dhe nëse në këtë grup, është i përfshirë një përfaqësues i banorëve që preken apo i qeverisjes lokale në Dibër?

Përgjigje: Ky është informacion që disponohet nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë.

Pyetje 8: Sa është shuma totale e projektuar për dëmshpërblim të banorëve?

Përgjigje: Strategjia e kompensimit dhe zhvendosjes si dhe vlerësimi i kostove përkatëse, janë po ashtu pjesë e studimeve dhe raporteve që janë duke u realizuar si pjesë e kësaj faze të parë të projektit. Qasja ndaj kompensimit dhe zhvendosjes, ashtu si gjithë vlerësimi i ndikimeve sociale dhe mjedisore, do të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të sektorit, veçanërisht Standardet e Performancës (SP) së IFC (International Finance Corporation). Kjo përcaktohet qartë edhe në VKM 485, datë 30.7.2021

Pyetje 9: Cila do të jete mënyra e dëmshpërblimit të banorëve? A do t'ju jepen shtëpi apo do të kompensohen me vlerë monetare? Çfarë roli do të luaj kontrata komerciale nëse do të jetë kjo forma ligjore në lidhje me banorët për këtë projekt?

Përgjigje: Qasja ndaj kompensimit dhe zhvendosjes do të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të sektorit, veçanërisht Standardet e Performancës (SP) së IFC (International Finance Corporation). SP-të e IFC në veçanti kërkojnë që të gjitha humbjet e shkaktuara nga Projekti të kompensohen me koston e zëvendësimit. Objektivi i përgjithshëm është që në përfundim të procesit të zhvendosjes jetesa e personave që do të zhvendosen të përmirësohet ose minimalisht të jetë e njëjtë me nivelin që ishte. Për më tepër,

duhet theksuar se e gjithë popullsia që do të preket nga ky projekt do të trajtohet në përputhje me SP-të e IFC.

Nëse në përfundim të studimit Projekti rezulton i realizueshëm (fizibël), atëherë do të ketë një proces të dedikuar ndaj zhvendosjes, të veçantë nga ai që po kryhet për VNMS-në. Ky proces do të përshkruhet dhe dokumentohet në një Plan Veprimi të Zhvendosjes. Gjithashtu, do të kryhet një proces i veçantë angazhimi me palët e interesit që do të ketë në fokus personat e prekur nga Projekti. Plan i Veprimit të Zhvendosjes do të nisë të përgatitet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022.

Për qëllime të hartimit të Planit të Veprimit të Zhvendosjes, Projekti do të ndërmarrë gjithashtu studimet e nevojshme për të përcaktuar:

- popullsinë e prekur
- sipërfaqen e tokës që do të duhet për Projektin
- vlerat e kompensimit për tokën
- vlerat e kompensimit për asetet
- planin e zhvendosjes për ato raste kur do të jete e nevojshme të aplikohet

Gjatë procesit të zhvendosjes, do të kryhet gjithashtu një census i popullatës dhe inventar i plotë asetesh, pronash dhe aktiviteteve që do të preken nga Projekti. Personat e prekur do të informohen në kohën e duhur mbi procesin e censusit dhe inventarit të aseteve.

KESH, Bechtel dhe partnerët e tjerë të projektit të fazës së parë, janë të angazhuar të realizojnë me komunitetet proceset e vrojtimit social në terren si dhe konsultimet e gjera me publikun, të cilat do të do të jenë mundësi për të marrë informacion dhe opinionin e tyre.

Pyetje 10: *A janë marrë parasysh mendimet e shoqërisë civile, akademikeve dhe aktivisteve që kërkojnë një projekt me më pak ndikim në komunitet? A ka patur tryeza konsultimesh me ekspertë dhe banorë dhe a do të shikohet projekti për të patur më pak ndikim?*

Përgjigje: Siç është përmendur edhe në përgjigjet më lart, gjatë fazës së hartimit të raportit janë realizuar angazhime të ndryshme në nivel lokal dhe qendror me qëllim grumbullimin e informacioneve të nevojshme. Më tej, me hartimin e draft raportit dhe nxjerrjes së konkluzioneve për projektin, marrja e opinionëve nga palët e interesit dhe publiku i gjerë do të realizohet nëpërmjet dëgjësave të hapura publike ku do të prezantohen ndikimet sociale dhe mjedisore të evidentuara si dhe masa e propozuara për eliminimin, minimizimin dhe trajtimin e tyre. Bazuar në legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, opinionet e marra nga palët e interesit në këto dëgjesa publike do të reflektohen më pas në raportin përfundimtar. Pra, projekti ka gjithë angazhimin e nevojshëm për të realizuar konsultimet me publikun sipas parashikimeve ligjore dhe standardeve ndërkombëtare dhe këto konsultime do të kryhen me përfundimin e studimeve dhe raporteve të nevojshme për t'ju prezantuar publikut. Raportet mbi angazhimet e kryera në të gjitha fazat e projektit, çështjet e diskutuara si dhe opinionet e marra do të jenë po ashtu një pjesë integrale raportit përfundimtar të VNMS.

Pyetje 11: *Mundet të kem praktikën që ka çuar Ministrinë e Infrastrukturës në vendimin për të çuar në parlament një projektligj ku kërkohet autorizimi për negociimin e kontratës me Bechtel.*

ndërkohë që më herët ministria ka thënë që do të ketë garë të hapur ndërkombëtare? Në cilin ligj është bazuar ministria për këtë vendim për të patur një ligj në parlament për këtë qellim?

Përgjigje: Ky është informacion që disponohet nga Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

ADMINISTRATOR

Ergys VERDHO

